



## FMN arrin marrëveshje në nivel stafi për Rishikimin e Katërt dhe të fundit të Marrëveshjes *Stand-By* dhe Instrumentit të Reziliencës dhe Qëndrueshmërisë për Kosovën

### PËR PUBLIKIM TË MENJËHERSHËM

Kumtesat për shtyp në përmbyllje të misionit përfshijnë deklaratat e ekipeve të stafit të FMN-së që përcjellin gjetjet paraprake pas vizitës në vend. Mendimet e shprehura në këtë deklaratë janë të stafit të FMN dhe nuk paraqesin medoemos mendimet e Bordit Ekzekutiv të FMN. Bazuar në gjetjet preliminare të këtij misioni, stafi do të përgatitë një raport i cili, nëse merr aprovimin e menaxhmentit, do të prezantohet para Bordit Ekzekutiv të FMN për diskutim dhe vendimmarrje.

- Stafi i FMN-së dhe autoritetet e Kosovës kanë arritur marrëveshje në nivel stafi lidhur me Rishikimin e Katërt dhe të fundit në kuadër të Marrëveshjes *Stand-By* (SBA) dhe Instrumentit të Reziliencës dhe Qëndrueshmërisë (RSF). Përmbyllja e Rishikimit vë në dispozicion shumë shtesë prej 13.35 milionë SDR (16.34 milionë euro) në kuadër të SBA-së dhe 7.74 milionë SDR (9.48 milionë euro) në kuadër të RSF-së. Marrëveshja duhet të pari të miratohet nga Bordi Ekzekutiv i FMN-së, ndërsa shqyrtimi nga Bordi pritet të bëhet në muajin maj. Autoritetet synojnë të vazhdojnë së trajtuar SBA-në si mekanizëm të kujdesit paraprak, dhe nuk do t'i tërheqin mjetet.
- Performanca e programit gjithashtu ka qenë e fuqishme. Autoritetet kanë përmbyllur të gjitha kriteret sasiore të performancës, caqet indikative dhe kriteret strukturore për Rishikimin. Është shënuar avancim në reforma dhe zbatim të agjendës së gjelbër, me mbështetje nga SBA dhe RSF.
- Performanca ekonomike ka vazhduar të jetë e fuqishme, me rritje të ndjeshme të BPV-së dhe ulje të inflacionit. Perspektiva në vijim është e favorshme por përballet me pasiguri, përfshirë ato nga zhvillimet ndërkombëtare gjeopolitike.

**Prishtinë, Kosovë – 20 mars 2025:** Një mision i FMN-së, i kryesuar nga David Amaglobeli, vizitoi Prishtinën gjatë periudhës 12–21 mars për diskutime në kuadër të Rishikimit të Katërt të Marrëveshjes *Stand-By* (SBA) dhe Instrumentit të Reziliencës dhe Qëndrueshmërisë (RSF) për Kosovën. Në përmbyllje të misionit, z. Amaglobeli lëshoi deklaratën si në vijim:

“Autoritetet kanë shënuar performancë të fuqishme në kuadër të SBA-së dhe RSF-së. Janë përmbyllur të gjitha caqet sasiore dhe indikative të fundit të dhjetorit për Rishikimin e Katërt, dhe objektivat për fundin e marsit janë në rrugë të mirë për t'u përmbyllur. Autoritetet kanë avancuar me reformat strukturore duke forcuar kapacitetin e parashikimit të likuiditetit në Ministrinë e Financave, si dhe duke iniciuar reformën madhore të modernizimit të mbikëqyrjes së sektorit financiar. Gjithashtu, ndonëse me një vonesë të shkurtër, autoritetet kanë zbatuar masën e fundit të reformës në kuadër të RSF-së, atë të lansimit të tenderit për energjinë e erës.”

“Programet dyvjeçare të mbështetura nga FMN-ja kanë dhënë rezultate të ndjeshme. Janë forcuar bazat makroekonomike duke ruajtur rritjen e fuqishme përkundër një mjedisi të jashtëm sfidues, duke frenuar inflacionin pas një rritjeje pas pandemisë, si dhe duke rritur punësimin në

sektorin formal. Rritja ekonomike arriti në 4.4 për qind në vitin 2024, e nxitur nga konsumi privat dhe investimet, duke ndihmuar që të kompensohet efekti i deficitit të zgjeruar tregtar dhe ngadalësimit të remitançave. Pritet që rritja të mbetet në 4 për qind në vitin 2025. Pas dy vitesh me presione të larta, inflacioni pati rënie në vitin 2024, duke shënuar një mesatare prej 1.6 për qind, pas ngadalësimit të inflacionit në ushqim dhe transport. Deficiti i llogarisë së jashtme rrjedhëse u zgjerua në 9 për qind të BPV-së në vitin 2024, nga 7.5 për qind në 2023, duke reflektuar rritjen e importeve të nxitura nga kërkesa e lartë e brendshme.”

“Politikat e kujdesshme fiskale kanë ndihmuar në mbajtjen e deficiteve dhe borxhit në nivel të ulët dhe në forcimin e rezervave fiskale. Deficitet ishin modeste, me 0.2 dhe 0.3 për qind të BPV-së në 2023 dhe 2024, përkatësisht; borxhi publik ra nën 17 për qind të BPV-së në vitin 2024, që ishte niveli më i ulët që nga viti 2017. Deri në fund të vitit 2024, depozitat e Thesarit në BQK—amortizues kyç kundër goditjeve—u rritën në 575 milionë euro. Reformat e suksesshme fiskale kanë nxitur mbledhjen e të hyrave, ndërsa raporti i tatimeve ndaj BPV-së arriti në 26½ për qind të BPV-së në 2024, që ishte niveli më i lartë ndonjëherë. Është përmirësuar transparencia, përfshirë ajo për ndërmarrjet publike dhe institucionet kyçe, siç është administrata tatimore. Reformat në menaxhimin e financave publike (MFP) kanë çuar në ekzekutim më efektiv të programit të investimeve publike. Për më tepër, reformat e zbatuara në kuadër të RSF-së, e para e këtij lloji në Evropë, kanë lehtësuar përpjekjet për të dyfishuar kapacitetin e prodhimit të energjisë së ripërtëritshme, për të përmirësuar eficiencën e energjisë dhe për ta ulur ndotjen.”

“Në periudhën në vijim, autoritetet duhet të vazhdojnë me zbatimin e politikave të kujdesshme fiskale, të mbështetura në një kornizë të fortë dhe të bazuar në rregulla, për të siguruar rezultate të qëndrueshme fiskale, nxitur rritje ekonomike, avancuar prioritetet sociale dhe forcuar reziliencën. Vazhdimi i reformave në administrimin e të hyrave do të krijojë hapësirë të nevojshme fiskale për më shumë investime sociale dhe kapitale, ndërsa reformat në MFP do të rrisin efikasitetin dhe ndikimin e shpenzimeve qeveritare. Përpjekjet për anëtarësim në BE do të jenë kyçe për të mobilizuar resurse financiare shtesë për adresimin e nevojave të mëdha zhvillimore të Kosovës. Përballë pasigurive në rritje, rezervat e mëdha fiskale dhe përgatitja më e mirë kundër krizave janë thelbësore për ta ruajtur stabilitetin dhe qëndrueshmërinë.”

“BQK ka shënuar përparim mbresëlënës në avancimin e reformave në sektorin financiar. Këto reforma synojnë të rrisin stabilitetin, reziliencën dhe modernizimin për të mbështetur aktivitetin ekonomik. BQK ka zbatuar me sukses reforma të rëndësishme institucionale të brendshme për të rritur efektivitetin, efikasitetin dhe transparencën. Në BQK është duke u realizuar vlerësimi i Kodit të Transparencës së Bankës Qendrore (CBT), nën udhëheqjen e FMN-së, si dhe auditimi i qeverisjes nga një bankë qendrore partnere, të cilat nënvizojnë zotimin e saj për praktikatat më të mira. Për më tepër, janë në zhvillim e sipër një numër nismash madhore për modernizimin e kuadrit rregullator të sektorit financiar, duke e përafruar atë me standardet e BE-së. Komponent kyç këtu është zbatimi i vazhdueshëm i Procesit të Rishikimit dhe Vlerësimit Mbikëqyrës (SREP), që gjerësisht konsiderohet si kuadri mbikëqyrës më i avancuar dhe më i strukturuar, për forcimin e mbikëqyrjes bankare të bazuar në rrezik. Gjithashtu, BQK është në proces të hartimit dhe funksionalizimit të kornizës së politikave makroprudenciale dhe forcimit të gatishmërinë ndaj krizave, duke përfshirë edhe përmes mbështetjes së zgjeruar së fundmi nga BQE (100 milionë euro). Rritja e primit nga bankat në Fondin e Sigurimit të Depozitave ka mundur një nivel shtesë të sigurisë. Janë bërë hapa të rëndësishëm për integrimin me Zonën e Vetme të Pagesave në Euro (SEPA) dhe zhvillimin e sistemit rajonal të pagesave të shpejta TIPS Clone. Këto nisma do të krijojnë një peizazh pagesash më të shpejta, më të sigurt dhe më kosto-efektive, nga i cili do të përfitojnë bizneset dhe qytetarët dhe njëkohësisht do të forcohet integrimi rajonal.”

“Këto reforma kanë mbështetur zgjerimin e shpejtë dhe të shëndetshëm të sektorit financiar. Pas një rritjeje prej 17 për qind në terma realë në vitin 2024, kreditë në sektorin privat arritën kulmin më 2024, duke tejkaluar 56 për qind të BPV-së. Është përmirësuar edhe gjithëpërfshirja financiare, me rritje të numrit të llogarive bankare ose parave elektronike dhe rritje të transaksioneve përmes Sistemit të Pagesave Ndërbankare të Kosovës (KIPS). Platforma e sapolansuar për Krahësimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare pritet të ndihmojë në rritjen e edukimit financiar dhe transparencës. Në këtë kontekst, sektori bankar vazhdon të jetë fitimprurës dhe i kapitalizuar mirë, me nivel të ulët të kredive joperformuese (KJP). Ruajtja e këtij stabiliteti kërkon vigjilencë të vazhdueshme dhe menaxhim proaktiv të rreziqeve.”

“Misioni u takua me Zëvendëskryeministrin Bislimi, Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve Murati, Ministren e Ekonomisë Rizvanolli, Guvernatorin e Bankës Qendrore Ismaili, si dhe me zyrtarë të tjerë të lartë, përfaqësues të shoqërisë civile, sektorin privat dhe partnerë ndërkombëtarë. Misioni shpreh mirënjohje, për ta dhe stafin e tyre teknik, për diskutime konstruktive dhe bashkëpunim gjatë mbarëvajtjes së misionit.”